

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

PROGRAMI

I KURSIT TË UNIFIKUAR

**“SHËRBIME NË BAR
DHE RESTORANT”**

Kodi: PK-G-4-18

Miratoi:

MINISTRI

.....

Tiranë, 2018

PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

“SHËRBIME NË BAR DHE RESTORANT”

(PK-G-4-18)

I. Profili Profesional për kamarier dhe banakier

a) Karakteristikat për shërbimet në bar dhe restorant

Kamarieri dhe banakieri janë të aftë të kryejnë *detyra* profesionale si të punësuar apo të vetpunësuar në sektorin e përgatitjes së pijeve dhe në sektorin e shërbimit të ushqimit dhe të pijeve në bare, restorante në “a la carte”, restorante të eventeve, hotele, agjenci katering, restorante lëvizëse, njësi vetshërbimi, menca etj.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, kamarieri dhe banakieri duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë e shërbimeve në bare dhe restorante.

Suksesi i kamarierit dhe banakierit është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e kamarierit dhe banakierit

Profesioni i kamarierit dhe banakierit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për mikpritjen dhe akomodimin e klientëve, parapërgatitjen (mise en place), marrjen e porosisë, përgatitjen e pijeve në bar, shërbimin e ushqimit dhe të pijeve, hartimin e faturave, mbylljet ditore, duke zbatuar rregullat dhe teknikat e shërbimit. Ai mund të punësohet ose vetpunësohet në bare, restorante “a la carte”, restorante të eventeve, hotele, njësi vetëshërbimi, agjenci katering, restorante lëvizëse, menca etj.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e kamarierit dhe banakierit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimit nëpërmjet punës, një kamarier dhe banakier mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si kryekamarier, shef salle, shef eventesh. Ndjekja e shkollës së lartë, çon në diplomimin e specialistëve të këtij profesioni në nivelin e menaxherit.

Për të zhvilluar aktivitet privat dhe për vetëpunësim, në veprimtarinë e shërbimeve të barit dhe restorantit, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësitë: “Kamarier”, me kod 5131 dhe “Banakier” me kod 5132 referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

Punonjësit në profesionin e kamarierit mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: kamarier për verë, kamarier në bare, kamarier në restorante, ndërsa punonjësit në profesionin e banakierit mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: banakier për kokteje, pije të ngrohta etj.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Shërbime në bar dhe restorant”.

Në përfundin të kursit për Shërbime në bar dhe restorant kursantët do të jenë të aftë të:

- zbatojnë rregullat e higjenës personale dhe paraqitjes në punë me uniformë.
- zbatojnë rregullat e qëndrimit, mbajtjes së trupit, lëvizjes në sallë gjatë punës.

- zbatojnë detyrat dhe rregulloret sipas funksionit dhe hirearkise.
- zbatojnë rregullat e sjelljes dhe komunikimit etik e profesional me klientët, kolegët, eprorët.
- punojnë në grup.
- zbatojnë rregullat e higjienës dhe mirëmbajtjes së mjedisit të punës.
- përdorin dhe mirëmbajnë mjetet, pajisjet dhe materialet e punës.
- lexojnë dhe interpretojnë dokumentacionin teknik të profesionit (menu, check-lista, axhenda e rezervimeve, faturat, etj).
- kryejnë “mise en place”, për përgatitjen e sallës, shtrimin e tavolinave dhe side board (dollapi i shërbimit), përpara gjatë dhe pas shërbimit.
- rregullojnë dhe shtrojnë tavolinat në mjedisin apo sallën e shërbimit.
- zbatojnë rregullat e mikpritjes, akomodimit, shërbimit në vazhdimësi dhe përcjelljes së klientit.
- prezantojnë menunë te klienti, duke zbatuar rregullat.
- marrin porosinë e ushqimit dhe pijeve në vazhdimësi, duke zbatuar rregullat.
- këshillojnë klientët në zgjedhjen e ushqimeve dhe pijeve.
- komunikojnë me banakun dhe kuzhinën për dhënie dhe marrjen e porosisë.
- përgatisin pije në banakun e barit duke zbatuar masat dhe teknikat e përgatitjes.
- kryejnë përlogaritje të thjeshta.
- përgatisin ushqime të thjeshta në banakun e barit.
- shërbejnë ushqimet dhe pijet në restorant dhe bar (“a la carte”, vetshërbim, pritje, bankete etj), duke zbatuar metoda të ndryshme të shërbimit.
- hartojnë faturën dhe kryejnë procedura të pagesës.
- kontrollojnë faturat e pagesave të bëra dhe bëjnë dorëzimet në arkë.
- bëjnë rakordimin e faturave me banakun dhe kuzhinën.
- hartojnë kërkesën për furnizim të barit dhe restorantit.
- kryejnë inventarizimin e ushqimeve, pijeve dhe materialeve të shërbimeve
- kryejnë furnizimet e duhura me fletë shoqërimi dhe fatura përkatëse.
- zbatojnë parimet e sigurisë, ruajtjes së pijeve dhe ushqimeve sipas llojit.
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për Shërbime në bar dhe restorant.

Pjesëmarrësit në Kursin për Shërbime në bar dhe restorant duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për Shërbime në bar dhe restorant.

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Shërbime në bar dhe restorant”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e kamarierit dhe banakierit	MK-13-108-18	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan funksionet, detyrat, rregullat dhe veprimtaritë kryesore të punës së kamarierit. 2. Kursanti zbaton rregullat e mbrojtjes në punë dhe të dhënies së ndihmës së parë. 3. Kursanti mirëmban sallën, pajisjet dhe mjetet e shërbimit në restorant 4. Kursanti shtron tavolinat në restorant, për shërbimin “a la carte” dhe me menu të thjeshta fikse të vaktit.
2	Shërbimi i ushqimit dhe i pijeve në restorant	MK-13-109-18	120 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti zbaton etapat, rregullat dhe rradhën e shërbimit te klienti në vazhdimësi. 2. Kursanti shërben pijet në tavolinën e klientit, në restorant. 3. Kursanti shërben ushqimet në tavolinën e klientit, në restorant, me metoda të ndryshme të shërbimit. 4. Kursanti shërben mëngjeset në restorant. 5. Kursanti kryen shërbimet speciale në gueridon.
3	Përgatitja dhe shërbimi i pijeve në bar	MK-13-110-18	120 orë Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan funksionet, detyrat, rregullat dhe veprimtaritë kryesore të punës së banakierit. 2. Kursanti përdor pajisjet dhe mjetet e punës në banakun e barit. 3. Kursanti përgatit pijet e ngrohta në bar. 4. Kursanti përgatit pijet në cocktail bar. 5. Kursanti përgatit ushqime në banakun e barit.
4	Shërbimi në bankete dhe pritje	MK-13-111-18	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti harton menu për bankete dhe pritje. 2. Kursanti kryen parapërgatitjen (mise en place) për shërbimin në bankete dhe pritje sipas fletë porosisë. 3. Kursanti shërben në bankete dhe pritje. 4. Kursanti sistemon mjedisin dhe pajisjet pas shërbimit të banketeve dhe pritjeve.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Shërbime në bar dhe restorant”.

1. Moduli “Hyrje në profesionin e kamarierit dhe banakierit”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E KAMARIERIT DHE BANAKIERIT	MK-13-108-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të kamarierit, me funksionet, detyrat, rregullat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e tij, me sigurinë në punë dhe dhënien e ndihmës së parë, me shprehitë për të përdorur dhe mirëmbajtur mjedisin, pajisjet dhe mjetet e punës në bar dhe restorant, si dhe për të rregulluar dhe shtruar sallën e restorantit në “a la carte” dhe me menu të thjeshta fikse të vaktit.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për praninë	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan funksionet, detyrat, rregullat dhe veprimtaritë kryesore të punës së kamarierit. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së kamarierit;- të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës së kamarierit;- të përshkruajë kërkesat profesionale për kamarierin;- të tregojë mundësitë e punësimit të kamarierit;- të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të kamarierit;- të zbatojë rregulla të paraqitjes, qëndrimit, mbajtjes së trupit gjatë kryerjes së detyrave në sallë;- të zbatojë rregulloren HACCAP gjatë veprimtarive të shërbimit në restorant;- të zbatojë rregulla të higjenës personale në punë;- të zbatojë rregulla të lëvizjes në sallë dhe mjediset ndihmëse;- të kujdeset për mjetet personale të punës;- të zbatojë rregullat universale të shërbimit në restorant;- të zbatojë rregullat komunikimit dhe të sjelljes me klientët duke mbajtur parasysh llojin e klientëve dhe nevojat e veçanta të tyre;- të mikpresë dhe përshëndesë klientët duke zbatuar kodin dhe etikën profesionale;- të zbatojë rregullat e bashkëpunimit, komunikimit dhe etikën me eprorët dhe kolegët.	

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti zbaton rregullat e mbrojtjes në punë dhe të dhënies së ndihmës së parë.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë rreziqet e dëmtimit të shëndetit, jetës dhe pronës për shkak të aksidenteve në vendin e punë;
- të tregojë shkaqet e aksidentet në vendin e punës;
- të zbatojë rregulloret e mbrojtjes dhe sigurisë në punë, në restorant dhe bar;
- të zbatojë sjellje që rrisin sigurinë nga dëmtuesit në vendin e punës;
- të menaxhojë sipas rregullave rastet e dëmtimeve në punë nga: rrëzimet, rrëshqitjet, prerjet nga thyerja e qelqeve, djegiet, dëmtimet nga energjia elektrike, dëmtimet nga detergjentët dhe desinfektantët, mbytje nga ushqimi, asfiksi, epilepsi, goditje në tru, atak kardiak, abuzimi me alkool, etj.
- të japë ndihmën e parë, në raste të aksidenteve në punë duke zbatuar rregullat përkatëse.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti mirëmban sallën, pajisjet dhe mjetet e shërbimit në restorant.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të respektojë rregullat e higjienës personale në vendin e punës;
- të sistemojë sallën e restorantit, mjediset ndihmëse të punës (offiss), mjedise të tjera të shërbimit sipas rregullave;
- të ajrosë dhe të pastrojë sallën e restorantit sipas rregullave;
- të kujdeset për lulet, perdet, muzikën dhe ndriçimin në sallë;
- të sistemojë dhe pastrojë pajisjet e sallës së restorantit si tavolina, karrige, side board, ekspozitorë etj;
- të përdorë sipas rregullit karrocet e shërbimit, vitrinat frigoriferifrike, vitrinat e ushqimeve të ngrohta, plate master, chafing dish, rechaud etj;
- të pastrojë dhe mirëmbajë sipas rregullit karrocet e shërbimit, vitrinat frigoriferifrike, vitrinat e ushqimeve të ngrohta, plate master, chafing dish, rechaud etj;
- të kontrollojë dhe zëvendësojë pajisjet e dëmtuara në sallë

- dhe mjediset ndihmëse;
- të përdorë dhe mirëmbajë tabakatë sipas rregullit;
 - të sistemojë dhe mirëmbajë mbulesat dhe pecetat në dollapin e shërbimit sipas llojit, madhësisë, rasteve të përdorimit;
 - të shtrojë dhe palosë mbulesat sipas rregullit;
 - të lajë, të thajë dhe të shkëlqejë pajisjet e takëmet e ngrënies (serviset) sipas llojit të materialeve dhe rregullave;
 - të vendosë takëmet e ngrënies në rafte sipas llojit dhe rasteve të përdorimit;
 - të mbartë takëmet e ngrënies sipas rregullave gjatë shërbimit;
 - të seleksionojë porcelanet sipas llojit dhe rasteve të përdorimit;
 - të lajë, të thajë, të shkëlqejë porcelanet sipas rregullit;
 - të vendosë porcelanet në rafte sipas rregullit;
 - të mbartë porcelanet (pjata, pjatanca, supjera, kana, filxhanë etj) duke zbatuar rregullat e mbartjes;
 - të seleksionojë pajisjet e qelqit sipas llojit dhe rasteve të përdorimit;
 - të lajë, të thajë, të shkëlqejë pajisjet e qelqit sipas rregullit;
 - të vendosë pajisjet e qelqit në rafte sipas rregullit;
 - të mbartë pajisjet e qelqit sipas rregullave të mbartjes;
 - të kontrollojë dhe zëvendësojë takëmet e ngrënies të dëmtuara;
 - të kujdeset për mjete të tjera të shërbimit në restorant sipas rregullave;
 - të kontrollojë dhe zëvendësojë mjetet e dëmtuara në restorant gjatë shërbimit;
 - të kujdeset për menazhet (mbajtëse kripe, piperi, vaji, uthulle, vazo lule etj);
 - të inventarizojë mjetet dhe pajisjet në restorant gjatë shërbimit;
 - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veprimtarive për mirëmbajtjen e sallës, pajisjeve dhe mjeteve të shërbimit në restorant.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti shtron tavolinat në restorant, për shërbimin “a la carte” dhe me menu të thjeshta fikse të vaktit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën e punës;
- të respektojë rregullat e higjienës personale në vendin e punës;
- të përshkruajë elementet e shtrimit të thjeshtë “a la

- carte” sipas standarteve të restoranteve;
- të tregojë rregullat e vendosjes së elementeve të shtrimit “a la carte” (sotopjata, pjata e bukës dhe e gjalpit, takëmet e ngrënies, gota, peceta, menazhe);
 - të hartojë listën e “mise en place”, për shtrimin e sallës së restorantit në “a la carte”, sipas numrit të vendeve të uljes;
 - të parapërgatitë “mise en place” për shtrimin e sallës së restorantit sipas numrit të vendeve të uljes;
 - të parapërgatitë sallën e restorantit për shtrimin “a la carte”;
 - të renditë tavolinat sipas skemës së shërbimit në “a la carte”;
 - të shtrojë mbulesat në tavolinat e restorantit sipas rregullit;
 - të vendosë menazhet në tavolinat e restorantit sipas rregullit;
 - të vendosë sotopjatat, pjatat e bukës dhe të gjalpit, takëmet e ngrënies, gotat, pecetat sipas rregullave të shtrimit dhe numrit të vendeve të uljes;
 - të rregullojë karriget pranë tavolinave sipas rregullit;
 - të kryejë kontrollin përfundimtar të shtrimit të sallës në “a la carte”;
 - të përshkruajë lloje të menuve në restorant;
 - të tregojë rregullat për ndërtimin dhe shkrimin e menuve;
 - të përshkruajë rradhën e vendosjes së ushqimeve dhe pijeve në një menu të thjeshtë fikse vakti;
 - të hartojë menu të thjeshta fikse të vaktit;
 - të tregojë rregulla të vendosjes së mjeteve në shtrimin për shërbimin e ushqimeve dhe pijeve në menu të thjeshta vakti (porcelanet, takëmet e ngrënies, gotat sipas ushqimeve dhe pijeve);
 - të skicojë modelin e shtrimit bazuar në një menu të thjeshtë fikse vakti;
 - të hartojë listën e “mise en place”, për shtrimin e tavolinave në sallën e restorantit për shërbimin e një menuje të thjeshtë fikse vakti sipas numrit të vendeve të uljes dhe fluksit të klientëve;
 - të hartojë listën e “mise en place”, për shërbimin e një menuje të thjeshtë fikse vakti, sipas numrit të vendeve të uljes dhe fluksit të klientëve;
 - të parapërgatitë “mise en place” për shtrimin e menisë së thjeshtë fikse të vaktit sipas numrit të vendeve të uljes dhe fluksit të klientëve;
 - të parapërgatitë “mise en place” për shërbimin e menisë së thjeshtë fikse të vaktit sipas numrit të vendeve të uljes dhe fluksit të klientëve;
 - të renditë tavolinat e restorantit për shtrimin e menuve të thjeshta fikse të vaktit bazuar në modelin e skicuar;

- të shtrojë mbulesat në tavolinat e restorantit për shtrimin e menuve të thjeshta fikse bazuar në modelin e skicuar;
- të vendosë menazhet në tavolinat e restorantit sipas rregullit;
- të shtrojë tavolinat bazuar në modelin e skicuar për shërbimin e një menuje të thjeshtë fikse vakti, sipas numrit të klientëve (sotopjatat, pjatat e bukës dhe të gjalpit, takëmet e ngrënies, gotat, pecetat, menu e shkruar vakti);
- të rregullojë karriget pranë tavolinave sipas rregullit;
- të kryejë kontrollin përfundimtar të shtrimit të sallës për shërbimin e një menuje të thjeshta fikse vakti;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë veprimtarive për shtrimin e tavolinave në restorant për shërbimin në “a la carte” dhe me menu të thjeshta fikse të vaktit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset reale e punës në bar dhe restorant. Rekomandohen dhe vizita në bare dhe restorante.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete. Atyre duhet t’ u jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit, funksionet, detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e kamarierit dhe banakierit, me sigurinë në punë dhe dhënien e ndihmës së parë, me shprehitë për të përdorur dhe mirëmbajtur mjedisin, pajisjet dhe mjetet e punës në bar dhe restorant, si dhe për të rregulluar dhe shtruar sallën e restorantit në “a la carte” dhe me menu të thjeshta fikse të vaktit.
- Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës.
- Gjatë vlerësimit duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materialet e nevojshme të restorantit ose restorant real .
 - Pajisje dhe mjete pune të restorantit të nevojshme për zhvillimin e veprimtarive.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Shërbimi i ushqimit dhe i pijeve në restorant”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	SHËRBIMI I USHQIMIT DHE I PIJEVE NË RESTORANT	MK-13-109-18
Qëllimi i modulit	Një modul që i aftëson kursantët në njohjen dhe zbatimin e etapave, rregullave dhe rradhën e shërbimit të klientit në vazhdimësi, shërbimin e pijeve, shërbimin e ushqimit në tavolinën e klientit me metoda të ndryshme të shërbimit, shërbimin e mëngjeseve dhe shërbimet speciale në gueridon.	
Kohëzgjatja e modulit	120 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e detyruar dhe të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e kamarierit dhe banakierit”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti zbaton etapat, rregullat dhe rradhën e shërbimit të klientit në vazhdimësi. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">- të veshë uniformën në vendin e punës;- të respektojë rregullat e higjienës personale në vendin e punës;- të përshkruajë etapat e shërbimit të klientit në vazhdimësi, që nga momenti i rezervimit e deri në momentin e përcjelljes;- të përshkruajë rregullat e lëvizjes dhe shërbimit;- të tregojë rradhën e shërbimit të klientit në tavolinë;- të zbatojë etapat e shërbimit të klientit sipas rregullit;- të kryejë rezervimin e tavolinave në restorant nga klientët me bllokun e rezervimeve;- të respektojë rezervimin e klientëve sipas rregullave;- të presë dhe të përshëndesë klientët sipas rregullave dhe etikës profesionale në restorant;- të ndihmojë klientët për garderobën dhe kërkesa të veçanta të tyre në restorant;- të bashkëpunojë dhe ndihmojë kolegët në pritjen e klientëve;- të shoqërojë dhe ulë klientët në tavolinë sipas rregullit;- të prezantojë menunë në tavolinat e klientëve duke zbatuar rregullat;- të sugjerojë aperitivë gjatë dhënies së menuve sipas rregullave;- të asistojë klientët gjatë zgjedhjes së ushqimeve dhe pijeve;- të sugjerojë ushqime dhe pije të klientët për të nxitur shitjet duke zbatuar rregullat;	

-
- të përshkruajë ushqimet te klienti sipas rregullave (origjina, historiku, teknika e gatimit, përbërësit etj);
 - të përshkruajë pijet te klient sipas rregullave (origjina, historiku, prodhimi, përbërësit, përmbajtja e alkoolit etj);
 - të marrë porosinë e klientëve në tavolinë duke zbatuar hapat, kodet dhe rregullat për marrjen e porosisë;
 - të kalojë porosinë e ushqimit në banak dhe kuzhinë sipas rregullave;
 - të zbatojë rradhën e shërbimit te klientët në sallë dhe tavolinë (fëmijët, të moshuarit, femrat, meshkujt);
 - të shërbejë pijet dhe ushqimet në vazhdimësi gjatë vaktit, sipas radhës dhe rregullave të shërbimit;
 - të ndërrojë pjatat, takëmet e ngrënies, gotat sipas rregullave gjatë vaktit;
 - të pastrojë tavolinën gjatë shërbimit sipas rregullave;
 - të pranojë sipas rregullit ankesa nga klienti;
 - të zbatojë rregullat e sjelljes me klientin në rast ankesash;
 - të përkujdeset për klientin sipas rregullave në rast ankesash;
 - të përkujdeset për klientin e inatosur sipas rregullave;
 - të zgjidhë ankesat e klientit në favor të klientit;
 - të përcjellë ankesat dhe sygjerimet e klientëve tek eprorët;
 - të hartojë faturën për klientin sipas rregullave;
 - t'i japë faturën klientit sipas rregullave;
 - të kryejë mënyra të ndryshme pagesash në restorant sipas rregullave;
 - të përcjellë klientët nga restoranti sipas rregullave;
 - të pastrojë tavolinën pas përfundimit të shërbimit sipas rregullit;
 - të shtrojë tavolinat për shërbimin e radhës sipas rregullit;
 - të menaxhojë mbetjet dhe ambalazhet sipas rregullave;
 - të zbatojë komandat e dhëna nga eprorët;
 - të përdorë makinat elektronike dhe kompjuterike në restorant;
 - të rakordojë faturat me banakun dhe kuzhinën;
 - të kryejë kontrollin e faturave dhe dorëzimet në arkë;
 - të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë shërbimit në restorant;
 - të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit në restorant.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 2 Kursanti shërben pijet në tavolinën e klientit, në restorant.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të respektojë rregullat e higjienës personale në vendin e punës;

- të përshkruajë llojet e pijeve në restorant, veçoritë, mënyrat e ruajtjes dhe treguesit cilësorë të tyre;
- të menaxhojë ruajtjen dhe qarkullimin e pijeve në restorant sipas rregullave;
- të lexojë etiketat e pijeve;
- të përzgjedhë gotat sipas llojit të pijeve në restorant;
- të respektojë temperaturën e shërbimit të pijeve sipas llojit;
- të pastrojë ambalazhet e pijeve përpara shërbimit në tavolinë sipas rregullave;
- të rregullojë sipas rregullit tabakanë për shërbim;
- të parapërgatisë mise en place në tabaka, në banakun e restorantit, në karrocën e shërbimit për shërbimin e pijeve sipas llojit;
- të përdorë tabakanë për shërbimin e pijeve sipas llojit duke zbatuar rregullat e mbartjes;
- të hapë shishet në prani të klientit dhe të shërbejë në krahun e djathtë duke zbatuar rregullat;
- të vendosë etiketat e pijeve me pamje nga klienti;
- të shërbejë ujin natyral dhe me gaz te klientët në tavolinë duke zbatuar hapat, rradhën dhe rregullat e shërbimit;
- të shërbejë pijet joalkoolike te klienti sipas llojeve dhe rregullave;
- të mbushë gotat e birrës së hapur në aparat sipas rregullave;
- të shërbejë birrat e hapura dhe nga shishja në tavolinën e klientëve sipas hapave, radhës dhe rregullave;
- të shërbejë verën e hapur sipas llojeve (e bardhë, e kuqe) te klienti duke zbatuar hapat, rradhën dhe rregullat e shërbimit;
- të parapërgatitë mise en place për shërbimin e verës së bardhë, nga shishja, në gueridon ose karrocën e shërbimit;
- të zbatojë procedurën e hapjes së shishes, kontrollit të verës së bardhë, përballë klientëve;
- të shërbejë verën e bardhë nga shishja te klienti duke zbatuar hapat, rregullat dhe rradhën e shërbimit;
- të parapërgatitë mise en place për shërbimin e verës së kuqe, nga shishja, në gueridon ose karrocën e shërbimit;
- të zbatojë procedurën e hapjes së shishes, kontrollit të verës së kuqe, përballë klientëve;
- të shërbejë verën e kuqe te klienti nga shishja duke zbatuar hapat, rregullat dhe rradhën e shërbimit;
- të parapërgatitë mise en place për shërbimin e verës së kuqe të vjetëruar nga shishja, në gueridon ose karrocën e shërbimit;
- të zbatojë procedurën e hapjes së shishes, kontrollit të verës së kuqe të vjetëruar, përballë klientëve;
- të shërbejë verën e kuqe të vjetëruar te klienti nga shishja duke zbatuar hapat, rregullat dhe rradhën e shërbimit;
- të parapërgatitë mise en place për shërbimin e verës

- shkumëzuese në gueridon ose karrocën e shërbimit;
- të zbatojë procedurën e hapjes së shishes, kontrollit të verës shkumëzuese, përballë klientëve;
- të shërbejë verën e shkumëzuese duke zbatuar hapat, rregullat dhe rradhën e shërbimit;
- të shërbejë pijet aperitive dhe dixhestive të klientit në tavolinë duke zbatuar hapat, rradhën dhe rregullat e shërbimit;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë shërbimit të pijeve në restorant;
- të menaxhojë mbetjet dhe ambalazhet gjatë shërbimit të pijeve në restorant;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit të pijeve në restorant.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti shërben ushqimet në tavolinën e klientit, në restorant, me metoda të ndryshme të shërbimit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të zbatojë rregulloren HACCAP gjatë veprimtarive të shërbimit në restorant;
- të përshkruajë metoda të shërbimit të ushqimit në tavolinën e klientit, në restorant;
- të listojë faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e metodës së shërbimit;
- të tregojë anët pozitive dhe të metat e metodave të shërbimit të ushqimit, të klientit në tavolinë;
- të listojë shërbimet në krahun e djathtë dhe të majtë të klientit për vendosjen e takëmeve të ngrënies, shërbimin e ushqimit dhe mbledhjen e pjatave të përdorura;
- të zbatojë rregullat për mbartjen, drejtimin e lëvizjes, krahun e shërbimit gjatë shërbimit të ushqimit në tavolinë;
- të vendosë takëmet e ngrënies së klientëve përpara shërbimit të ushqimit me pjatë në tavolinë, duke zbatuar rregullat e mbartjes;
- të shërbejë ushqimin me pjatë të klientit në tavolinë duke zbatuar teknikat e mbartjes së sipërme dhe të poshtme të pjatave;
- të shërbejë ushqime me pjatë dhe pjatanca të nxehta të klientit në tavolinë duke zbatuar rregullat dhe teknikat e mbartjes;
- të shërbejë supën të klientit në tavolinë duke zbatuar rregullat e teknikat e mbartjes;
- të mbledhë pjatat e përdorura në tavolinën e klientëve duke zbatuar rregullat dhe teknikat e mbartjes;

- të shërbejë ushqimin me cloche ose kapak duke zbatuar rregullat dhe teknikat e mbartjes;
- të vendosë pjatat dhe takëmet e ngrënies së klientëve përpara shërbimit të ushqimit me pjatancë duke zbatuar rregullat dhe teknikat e mbartjes;
- të përdorë clips ose forleger për shpërndarjen e ushqimit;
- të shërbejë pjatancat me ushqim te klienti duke zbatuar rregullat dhe kahun e shërbimit;
- të vendosë pjatat dhe takëmet e ngrënies së klientëve përpara shërbimit të ushqimit me metodën angleze të shërbimit duke zbatuar rregullat e mbartjes;
- të përdorë clips ose forleger për shpërndarjen e ushqimit;
- të shërbejë me metodën angleze ushqim te klienti, duke zbatuar rregullat, teknikat dhe kahun e shërbimit;
- të mbledhë pjatat e përdorura në tavolinën e klientëve duke zbatuar rregullat dhe teknika e mbartjes;
- të vendosë takëmet e ngrënies së klientëve përpara shërbimit të ushqimit me metodën gueridon të shërbimit duke zbatuar rregullat e mbartjes;
- të parapërgatitë gueridonin për shërbimin e ushqimit për një numër të caktuar klientësh;
- të përdorë clips ose forleger për shpërndarjen e ushqimit nga gueridoni;
- të përgatitë pjatat me ushqim në gueridon duke zbatuar rregullat për vendosjen e ushqimeve në pjatë;
- të përgatitë pjatat me ushqim në gueridon duke zbatuar rregullat e porcionimit, dekorit;
- të shërbejë pjatat me ushqim nga geridoni duke zbatuar hapat, rregullat dhe rradhën e shërbimit;
- të shërbejë me metoda të ndryshme ushqimet (bukë, sallatë, supë, pjata kryesore etj) duke zbatuar rregullat dhe teknikat e shërbimit;
- të pastrojë tavolinën e klientit duke zbatuar rregullat dhe teknikat;
- të menaxhojë mbetjet e ushqimeve në restorant;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit gjatë shërbimit me metoda të ndryshme të shërbimit, në tavolinën e klientit në restorant;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë shërbimit me metoda të ndryshme të shërbimit në tavolinën e klientit në restorant.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti shërben mëngjeset në restorant.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të veshë uniformën në vendin e punës;
- të respektojë rregullat e higjienës personale në vendin e

- punës;
- të përshkruajë lloje të mëngjeseve në restorant;
 - të listojë faktorët që ndikojnë në përzgjedhjen e llojit të mëngjesit të ofruar;
 - të tregojë anët pozitive dhe të metat e mënyrave të ndryshme të ofrimit të mëngjesit për restorantin dhe klientin;
 - të skicojë modele të shtrimit në tavolinën e klientit për shërbimin e llojeve të ndryshme të mëngjesit (early tea, mëngjes i thjeshtë, mëngjes kontinental, mëngjes anglez amerikan, mëngjes “a la carte”, brunch, mëngjes me bufe);
 - të analizojë skemën e shërbimit për mëngjeset sipas llojit;
 - të planifikojë sipas rregullit shërbimin për mëngjeset sipas llojit, menues dhe numrit të pritshëm të klientëve;
 - të parapërgatisë dhe sistemojë sallën e restorantit për shërbimin e mëngjeseve sipas llojit;
 - të parapërgatisë mjetet dhe shtrimet në tavolina për shërbimin e mëngjesit sipas hapave dhe rregullave, në “a la carte”, “early tea”, mëngjes i thjeshtë, mëngjesi kontinental, mëngjes anglez amerikan, mëngjes bufe;
 - të kryejë kontrollin e gadishmërisë së sallës përpara fillimit të shërbimit;
 - të kryejë parapërgatitjet në side board, banak dhe kuzhinë për shërbimin e mëngjeseve sipas llojit;
 - të mikpresë sipas rregullit klientët në mëngjes;
 - të shërbejë sipas rregullit pijet dhe ushqimet në mëngjesin “a la carte”;
 - të shërbejë sipas rregullit pijet dhe ushqimet në mëngjesin e thjeshtë;
 - të shërbejë sipas rregullit pijet dhe ushqimet në mëngjesin kontinental;
 - të shërbejë sipas rregullit pijet dhe ushqimet në mëngjesin anglez dhe amerikan ;
 - të planifikojë shërbimin e mëngjesit me bufe dhe brunch për një numër të caktuar klientësh;
 - të parapërgatitë mise en place dhe të shtrojë sallën për shërbimin e mëngjesit me bufe (vetshërbim i plotë, pijet shërbehen në tavolinë, buka dhe pijet shërbehen në tavolinë);
 - të parapërgatitë mise en place dhe të shtojë tavolinën për shërbimin e brunch;
 - të parapërgatitë pijet dhe ushqimet për bufenë e mëngjesit në offisse;
 - të parapërgatitë sipas rregullit bufenë e pijeve;
 - të parapërgatitë sipas rregullit bufenë e ushqimieve të ngrohta e të ftohta;
 - të plotësojë ushqimet dhe pajisjet e përfunduara në bufe sipas rregullit;
 - të asistojë klientët në sallë për nevoja të ndryshme gjatë

- shërbimit në bufenë e mëngjesit;
- të shërbejë sipas rregullit në bufenë e mëngjesit dhe brunch;
- të pastrojë tavolinat dhe sallën gjatë dhe pas përfundimit të vaktit;
- të kryejë pagesën e mëngjeseve sipas rregullit;
- të përcjellë klientët sipas rregullit;
- të pastrojë tavolinat sipas rregullit;
- të sistemojë dhe shtrojë sallën sipas rregullit;
- të rishtrijë tavolinat për shërbimin e vaktit të rradhës;
- të kujdeset për side board sipas rregullit;
- të rakordojë faturat me banakun dhe kuzhinën;
- të kryejë kontrollin e faturave dhe dorëzimet në arkë;
- të zbatojë kërkesat e kujdesit ndaj shëndetit dhe sigurisë së klientit në restorant;
- të zbatojë rregullat e higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në restorant gjatë shërbimit të mëngjeseve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti kryen shërbimet speciale në gueridon.

